

KËRKESË
Nr. 1695/7, datë 8.5.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës – Qafë-Thanë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlera totale e shpronësimit është 1 133 763 (një milionë e njëqind e tridhjetë e tri mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

Pronarët, për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi